VENDIM
Nr. 93, datë 27.2.2019

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE DHE TË PAGESAVE PËR SHËRBIMET NDAJ INSTITUCIONEVE APO PERSONAVE, QË OFROHEN NGA AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit nr.45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Kërkesat e subjekteve të parashikuar në pikat 3, 6 dhe 9, të nenit 3, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", për dhënie informacioni dhe/ose vënie në dispozicion të dokumenteve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, plotësohen kundrejt tarifave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij vendimi institucionet për të cilat marrja e shërbimit nga Autoriteti përcaktohet në ligj që të jetë pa pagesë.

3. Tarifa, në kuptim të këtij vendimi, është kostoja e riprodhimit të informacionit dhe/ose dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, të kërkuar dhe, kur është rasti, edhe e dërgimit të tij.

4. Personat e regjistruar në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", e përfitojnë informacionin dhe/ose dokumentacionin pa pagesë deri në 20 fletë, për çdo kërkesë, ose në vlerën ekuivalente, kur informacioni jepet në një format tjetër, pas vërtetimit të statusit përkatës.

5. Riprodhimi i dokumenteve të kërkuara do të bëhet nga drejtoria/sektori përkatës, me mjetet e riprodhimit që disponon Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

6. Institucionet, personat dhe subjektet e interesuara, paguajnë tarifat përkatëse në llogarinë e Autoritetit pranë një banke të nivelit të dytë, sipas faturës së arkëtimit bashkëlidhur këtij vendimi. Me pagesën e tarifës përkatëse dhe paraqitjen e mandatit bankar pranë Autoritetit, dokumentet e kërkuara nga kërkuesi i dërgohen me postë, ose i dorëzohen kërkuesit/subjektit të interesuar.

7. Të ardhurat e realizuara derdhen në buxhetin e shtetit, në përputhje me legjislacionin në fushën e krijimit dhe të administrimit të të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore.

8. Publikimi i tarifave të përcaktuara në shtojcën nr. 1 bëhet në faqen zyrtare të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe në mjediset e punës së Autoritetit.

9. Tarifat për fotokopjet dhe/ose kopjet në formë digjitale, regjistrimet me zë, figurë apo regjistrime të tjera, me apo pa të drejta përdorimi, për përdorim privat apo studimor, në kuadër të marrëveshjeve ndërinstitucionale, do të trajtohen sipas këtyre marrëveshjeve.

10. Ngarkohet Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

TARIFAT PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Nr.	Tarifa për shërbimet që kryhen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	Vlera e tarifës në lekë
1.	Fotokopje/printim bardhë e zi, Format A4 (1-20 fletë), ku përfitues janë kategoritë që trajtohen sipas ligjit nr.111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" dhe personat e regjistruar në skemat e ndihmës shoqërore.	Pa pagesë
2.	Fotokopje/printim bardhë e zi, Format A4	10 lekë/fletë
3.	Fotokopje/printim bardhë e zi, Format A3	15 lekë/fletë
4.	Fotokopje/printim me ngjyra, Format A4	20 lekë/fletë
5.	Fotokopje/printim me ngjyra, Format A3	30 lekë/fletë
6.	Skanime	10 lekë/fletë
7.	Tarifat e *CD*-së	50 lekë/copë
8.	Tarifa për riprodhime të regjistrimeve me zë, figurë, apo regjistrime të tjera (pa të drejta përdorimi)	50 lekë/minutë
9.	Tarifa për riprodhime të regjistrimeve me zë, figurë, apo regjistrime të tjera për përdorim studimor (me të drejta përdorimi)	1.500 lekë/minutë
10.	Tarifa për qëllime studimore për studiuesit	20 lekë / fletë
11.	Tarifa për qëllime studimore për studentët	5 lekë / fletë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

FATURË PËR ARKËTIM

BANKËS:_____

Me anë të kësaj fature, kërkojmë që banka Juaj të pranojë nga klientë (persona, persona fizikë, dhe juridikë) arkëtime të të ardhurave për llogari të Institucionit tonë, me emërtimet, kodet dhe shumat si më poshtë:

Emri i Institucionit përfitues **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**

NIPTI/ NUIS

Kodi i Institucionit përfitues _____

Kodi i Degës së Thesarit ku vepron _____

Nr. Llogarisë së Thesarit (Të Ardhura) _____

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave	Kodi i llogarisë ekonomike	Shuma që do të arkëtohet {lekë}
1.			
2.			
	TOTALI		

PËR INSTITUCIONIN **PËR SUBJEKTIN E INTERESUAR**

_____ _____